



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 01/71  
Datë: 23.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet 66 dhe 67 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/71  
Datë: 23.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 40,000,00 (katërdhjetë mijë) euro, për përmbushjen e kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2018 në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, me seli në Sarajevë, respektivisht në buxhetin e Sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Republika e Kosovës bën pjesë në grupin prej 4 % të shumës totale të vendeve të Evropës Juglindore (përcaktuar formalisht në Takimin e Tryezës Rajonale të Paktit të Stabilitetit për EJL në Bukuresht, Nëntor 2006).
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Financave, nën-programi i Thesarit me kod 11200, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere, dhe barten në buxhetin e Sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, me seli në Sarajevë.
3. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/71

Datë: 23.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh nenin 16 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Draft-Strategjia Shtetërore Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit 2018-2022.
2. Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Me hyrjen në fuqi këtij vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 02/37 i datës 23.03.2018.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/71  
Datë: 23.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 200,000 (dyqind mijë euro) në bazë të kërkesës së përbashkët të Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) dhe agjencioneve të Kombeve të Bashkuara që veprojnë në Kosovë.
2. Mjetet nga paragrafi 1. i këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të Rezervës, për entitetin implementues të MCC në Kosovë, dhe do të shfrytëzohen për:
  - a. verifikim dhe publikim të indikatorëve kryesorë të qeverisjes për vitin 2018 dhe
  - b. përgatitjet për kalimin në programin Kompakt.
3. Mjetet nga pika 2. transferohen në Ministrinë e Financave nën programi Thesarit me kod 11200 në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere.
4. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/71

Datë: 23.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Rregullorja për Procedurat dhe Format e Njoftimit për Ndhimën Shtetërore.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/71

Datë: 23.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 15-62 të datës 28.08.2018 për shpronësimin për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit dhe të ndërtesave të ish NSh "Germia" Prishtinë, Qeveria merr në obligim të bëjë pagesën sipas nenit 6A, paragrafit 3 të Ligjit të AKP-së nr. 06/L-023 të 20% të shumës totale të shpronësimit dhe vlerën e kërkesave eventuale nga kreditorët të Ndërmarrjes Shoqërore nga Autoriteti i Likuidimit.
2. Ndërtesa do të destinohet për krijimin e sallës koncertale.
3. Ndërtesës i ruhet pamja e jashtme në pajtim me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore.
4. Ndërtesa do të menaxhohet nga Komuna e Prishtinës.
5. Komuna e Prishtinës obligohet të jetë pjesë e pagesave gjatë procedurës së bartjes së pronës në Qeveri, përkatësisht në Komunë.
6. Ministria e Financave obligohet që të sigurojë mjetet në periudhë kohore brenda 3 vjetëve duke u bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
7. Autorizohet Ministria e Administratës Publike për deponim të letër zotimit për pagesat tjera të nevojshme sipas nenit 6A të paragrafit 3 të Ligjit nr. 06/L-023 dhe në bashkëpunim me institucionet tjera të bëjë bartjen e pasurisë.
8. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komuna e Prishtinës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/71  
Datë: 23.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 14-68 të datës 09.10.2018 për shpronësimin për interes publik i pronave të paluajtshme pronarëve dhe zotëruesve të interesit dhe të ndërtesave të "Objekti afarist-përdhese ish Barnatorja e Qytetit" Prishtinë, Qeveria merr në obligim të bëjë pagesën sipas nenit 6A, paragrafit 3 të Ligjit të AKP-së nr. 06/L-023 të 20% të shumës totale të shpronësimit dhe vlerën e kërkesave eventuale nga kreditorët të Ndërmarrjes Shoqërore nga Autoriteti i Likuidimit.
2. Për zbatimin e vendimit obligohet Ministria e Financave që të sigurojë mjetet në periudhë kohore brenda 3 vjetëve duke u bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
3. Autorizohet Ministria e Administratës Publike për deponim të letër zotimit për pagesat tjera të nevojshme sipas nenit 6A të paragrafit 3 të Ligjit nr. 06/L-023 dhe në bashkëpunim me institucionet tjera të bëjë bartjen e pasurisë në emër të Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/71  
Datë: 23.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 08-189 të datës 23.05.2014 për shpronësimin për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit dhe të ndërtesave të ish NSh "Rilindja" Prishtinë, Qeveria merr në obligim të bëjë pagesën sipas nenit 6A, paragrafit 3 të Ligjit të AKP-së nr. 06/L-023 të 20% të shumës totale të shpronësimit dhe vlerën e kërkesave eventuale nga kreditorët të Ndërmarrjes Shoqërore nga Autoriteti i Likuidimit.
2. Për zbatimin e vendimit obligohet Ministria e Financave që të sigurojë mjetet në periudhë kohore brenda 3 vjetëve duke u bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
3. Autorizohet Ministria e Administratës Publike për deponim të letër zotimit për pagesat tjera të nevojshme sipas nenit 6A të paragrafit 3 të Ligjit nr. 06/L-023 dhe në bashkëpunim me institucionet tjera të bëjë bartjen e pasurisë në emër të Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/71  
Datë: 23.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 06-/104 të datës 10.08.2016 për shpronësimin për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit dhe të ndërtesave së ish "Banka Themelore e Bankës së Lubjanës" Prishtinë, Qeveria merr në obligim të bëjë pagesën sipas nenit 6A, paragrafit 3 të Ligjit të AKP-së nr. 06/L-023 të 20% të shumës totale të shpronësimit dhe vlerën e kërkesave eventuale nga kreditorët të Ndërmarrjes Shoqërore nga Autoriteti i Likuidimit.
2. Për zbatimin e vendimit obligohet Ministria e Financave që të sigurojë mjetet në periudhë kohore brenda 3 vjetëve duke u bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
3. Autorizohet Ministria e Administratës Publike për deponim të letër zotimit për pagesat tjera të nevojshme sipas nenit 6A të paragrafit 3 të Ligjit nr. 06/L-023 dhe në bashkëpunim me institucionet tjera të bëjë bartjen e pasurisë në emër të Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/71  
Datë: 23.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 260 të Ligjit Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 32/5 shtator 2016) duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Infrastrukturës për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Trafikut Rrugor (KSTRR).
2. KSTRR do të përbëhet nga:
  - Ministri i Infrastrukturës - kryesues;
  - Ministri i Punëve të Brendshme - anëtar;
  - Ministri i Drejtësisë - anëtar;
  - Ministri i Shëndetësisë - anëtar;
  - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë - anëtar;
  - Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - anëtar;
  - Ministri i Integritimit Evropian;
  - Kryesuesi i Asociacionit të Komunave - anëtar dhe
  - një përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit - anëtar.
3. Ministria e Infrastrukturës do të ofrojë shërbimet administrative dhe të sekretarisë për anëtarët e KSTRR-se.
4. KSTRR do të ketë këto kompetenca:
  - zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe masave në fushën e sigurisë rrugore;
  - ngritjen e vetëdijes publike për çështjet e sigurisë rrugore nëpërmjet organizimit të fushatave të përhershme promovuese;
  - koordinimin e punës së të gjitha institucioneve të cilat janë të përfshira në sigurinë e trafikut rrugor;
  - koordinimin e punës me të gjitha subjektet tjera për promovimin e sigurisë së trafikut rrugor.
5. KSTRR mund të themelojë grupe punuese në fushat përkatëse të përbëra nga ekspertë të ndryshëm, përfaqësues të organizatave joqeveritare (OJQ) që mbrojnë interesat e shoqërisë në sigurinë rrugore, për të shqyrtuar dhe analizuar çështjet e veçanta dhe për të dhënë rekomandime për rritjen e sigurisë rrugore.

6. Këshilli mund të emërojë persona përgjegjës për zbatimin e veprimeve, masave dhe politikave në fushën e sigurisë rrugore edhe në nivel rajonal.
7. Koordinimi i punës së KSTRR dhe institucioneve dhe subjekteve tjera do të bëhet nga sekretaria e KSTRR.
8. Kryesuesi i KSTRR do të raportojë përmes Qeverisë së paku një (1) herë brenda një viti para Kuvendit të Kosovës për sigurinë në trafikun rrugor.
9. KSTRR mund të nxjerrë akte juridike për zbatimin e masave dhe veprimeve konkrete me qëllim të rritjes së sigurisë së trafikut rrugor të cilat do të jenë të obligueshme për të gjitha institucionet dhe subjektet të cilave iu drejtohen.
10. Obligohet Ministria e Financave, që sipas kërkesës së kryesuesit të KSTRR të sigurojë mjete financiare për punën e KSTRR, angazhimin e ekspertëve të jashtëm, dhe grupet punuese.
11. Obligohet Ministria e Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
12. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 11/71  
Datë: 23.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për kërkesën e Komunës së Vushtrisë për tërheqjen nga procesi i privatizimit dhe kthimin e pronës në pronësi të komunës, e cila aktualisht është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me qëllim të realizimit të interesit publik në komunën e Vushtrisë.
2. Zonat Kadastrale të cilat janë objekt i këtij vendimi janë: Njësia Kadastrale P-70202016-01431-0 me sipërfaqe prej 16747 m<sup>2</sup>; P-70202016-02231-0 me sipërfaqe prej 15990 m<sup>2</sup>; P-70202016-02253-5 me sipërfaqe prej 3633 m<sup>2</sup>; ngastra me nr. 4103-1 me sipërfaqe prej 5696 m<sup>2</sup>; ngastra me nr. 4104 me sipërfaqe prej 21826 m<sup>2</sup>.
3. Kompensimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumën prej njëzet për qind (20%) të vlerës së pronës sipas vlerësimit, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore, si dhe kërkesat e kreditorëve nga procesi i likuidimit deri në shumën e përgjithshme të vlerësimit, do të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
4. Prona nga pika 2. e këtij vendimi, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç destinimit të përcaktuar.
5. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që të zhvillojë procedurat e mëtejme me Agjencionin Kosovar të Privatizimit, deri në vendimin përfundimtar për bartje të pronës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


Nr. 12/71  
Datë: 23.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MMPH-së, nr. prot. 5738/18, datë 11.10.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R**

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit të infrastrukturës - ndërtimi i Autostradës "Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë" Segmenti Banullë - Bresallc, që prek Komunat Lipjan (Zonat Kadastrale Banullë, Sllovi, Smallushë), Novobërdë (zona kadastrale Parallovë) dhe Gjilan (zonat kadastrale Bresalc, Ponesh dhe Zhegovc), sipas tabelave pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse e këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas "Shkresës përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" nr. protokolli 4998/18 datë 31.08.2018 dhe tabelave nr. protokolli nr.5592/18 datë 27.09.2018.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në këtë vendim.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 13/71  
Datë: 23.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti Nëntëmujor Financiar i Buxhetit për vitin 2018.
2. Raporti nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, konform kërkesave të nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 14/71


Datë: 23.10.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Punëve të Jashtme për lidhjen e “Marrëveshjes për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave Diplomatike dhe Zyrtare” ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Panamasë.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme që të zhvillojë negociata me Panamanë me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes së lartcekur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë